



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-112/22-0094342/22 dt. 19.10.2022

Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 pika të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtar/es Përgjegjës për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik)

1. **Emërohet** znj. Blerina Kastrati Idrizi, Zyrtare Përgjegjëse për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik për komunën e Mitrovicës Jugore.
2. Zyrtar-ja e emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi është e obliguar që të bëjë përgatitjen e formularëve shpjegues të projekt-propozimit për konsultim publik dhe dokumentacionit përcjellës, koordinimin e konsultimit publik në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e Draftit fillestar të Projekt-Propozimit dhe Grupin Punues, përcjelljen e afateve kohore për procesin e Konsultimit Publik, dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisive të tjera konform dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.
3. Zyrtar-ja përgjegjëse obligohet që të përgatisë raporte vjetore për procesin e Konsultimit Publik në Komunë, dhe për të njëjtat raporton tek Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Përgjegjëse për Monitorim të Komunave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Në rast të mungesës së Zyrtar-es së emëruar për koordinimin e procesit të Konsultimit Publik, kompetente është Zyra për Informim.

B.



5. Mandati i Zyrtares së emëruar është 1 (një) vjeçar me mundësi vazhdimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 znj. Blerina Kastrati Idrizi
- 1x1 Arkivit



Kryetari i Komunës

Bedri Hamza
Bedri HAMZA

